



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

VENDIM

Nr. 225, datë 25.04.2024

MBI

**PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR TRAJNERË/EKSPERTË E
LEHTËSUES, QË DO TË OFROJNË PROGRAMIN E FORMIMIT
FILLESTAR DHE VAZHDUES PËR NËPUNËSIT CIVILË GJYQËSORË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të KLG nr. 224 datë 25.04.2024, “Për miratimin e “Rregullores për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë”,

V E N D O S I:

1. Për zhvillimin e programit të formimit fillestar dhe vazhdues apo TOT, KLGJ-ja lidh kontratë me trajnerë/ekspertë/ e lehtësues, të cilët ndahen në tre kategori:
 - a) Trajnerë/ekspertë/lehtësues, të kategorisë së ulët, trajnerët që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 5-7 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
 - b) Trajnerë/ekspertë/lehtësues, të kategorisë së mesme, trajnerët që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 8-15 vite përvojë pune në fushën përkatëse, ose trajnerët që kanë një diplomë postmaster apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe, minimalisht, 3 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
 - c) Trajnerë/ekspertë/lehtësues, të kategorisë së lartë, trajnerët që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe mbi 15 vite përvojë pune në fushën përkatëse ose trajnerët që kanë një gradë apo titull shkencor.
2. Niveli i pagesës përcaktohet në kontratë dhe llogaritet në varësi të kategorisë ku përfshihet trajneri/eksperti/lehtësuesi, dhe të orëve të trajnimit, bazuar në lidhjen nr.1, pjesë e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

<i>Kategoria trajnerë/ekspertë/lehtësues</i>	<i>Masa e pagesës</i>
I ulët	750 lekë/orë 60 minutëshe
I mesëm	1000 lekë/orë 60 minutëshe
I lartë	1500 lekë/orë 60 minutëshe